

**MARRËVESHJE ADMINISTRATIVE  
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KROACISË  
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE**

Autoritetet Kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetet Kompetente të Republikës së Kroacisë,

Në përputhje me paragrafin 1 të Nenit 24 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për Mbrojtjen Shoqërore, nënshkruar në Zagreb datë 2/10/2023, (më tej referuar si "Marrëveshja"),

Kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

**PJESA I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Përkufizime**

1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje Administrative do të kenë të njëjtin kuptim si në Marrëveshje.
2. Për qëllimin e të drejtës së përfitimeve në natyrë në këtë Marrëveshje Administrative, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
  - (a) "Institucioni" – organi ose institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të përmendur në Nenin 2, paragrafi 1 i Marrëveshjes.
  - (b) "Institucioni kompetent" – institucioni me të cilin personi i interesuar është i siguruar në momentin e aplikimit të përfitimeve në natyrë.
  - (c) "Institucioni i vendqëndrimit" – institucioni i cili është kompetent për të ofruar përfitime në natyrë në vendin e qëndrimit të personit të siguruar.

**Neni 2  
Organet Ndërlidhëse dhe Institucionet Kompetente**

1. Organet Ndërlidhëse dhe Institucionet Kompetente të përmendura në paragrafin 2 të Nenit 24 të Marrëveshjes do të jenë:
  - Për sa i përket Shqipërinë,
    - a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore
    - b) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
  - Për sa i përket Kroacinë,
    - a) Instituti Kroat i Sigurimeve për Pensionet;
    - b) Fondi Kroat i Sigurimeve Shëndetësore;
    - c) Shërbimi Kroat i Punësimit

2. Organet ndërlidhëse do të vendosin së bashku për procedurat dhe format e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes dhe kësaj Marrëveshjeje Administrative.

### **Neni 3**

#### **Transferimi i përfitimeve**

Përfitimet e përmendura në Nenin 5 të Marrëveshjes u paguhen direkt personave të përcaktuar në Nenin 3 të Marrëveshjes.

## **PJESA II**

### **LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

### **Neni 4**

#### **Vërtetim mbi legjislacionin e zbatueshëm**

1. Kur legjislacioni i njërës Palë Kontraktuese është i zbatueshëm në përputhje me ndonjë nga dispozitat e Pjesës II të Marrëveshjes, Institucioni Kompetent i asaj Pale Kontraktuese do të lëshojë, me kërkesën e një punëdhënësi ose një personi të vetëpunësuar, një vërtetim duke deklaruar se punonjësi ose personi i vetëpunësuar i nënshtrohet legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese dhe duke shprehur kohëzgjatjen për të cilën vërtetimi do të jetë i vlefshëm. Ky vërtetim vërteton se punonjësi ose personi i vetëpunësuar është i përjashtuar nga legjislacioni për mbulimin e detyrueshëm të Palës tjetër Kontraktuese.
2. Vërtetimi i kërkuar nga paragrafi 1 i këtij Neni, lëshohet nga:
  - Për sa i përket Shqipërisë:
    - a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore
    - b) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
  - Për sa i përket Kroacisë:

Njësia organizative kompetente vendore e Fondit Kroat të Sigurimeve Shëndetësore,
3. Institucioni kompetent i njërës palë kontraktuese, i cili lëshon vërtetimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni, do t'i japë një kopje të këtij vërtetimi punonjësit ose të vetë punësuarit në fjalë, si dhe punëdhënësit të punëmarrësit dhe organit ndërlidhës të Palës tjetër Kontraktuese.

## **PJESA III**

### **DISPOZITAT PËR PËRFITIMET**

### **Kreu I**

#### **PËRFITIMET PËR SËMUNDJE DHE BARRËLINDJE**

## **Neni 5**

### **Bashkimi i periudhave të sigurimit**

1. Me qëllim zbatimin e Nenit 12 të Marrëveshjes, personi i siguruar është i detyruar të paraqesë një dokument të lëshuar nga një Institucion Kompetent i cili vërteton periudhat e sigurimit të njohura nga legjislacioni i Palës tjetër Kontraktuese. Një dokument i tillë, me kërkesë të personit të siguruar, lëshohet nga:

- Për sa i përket Shqipërisë:  
Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- Për sa i përket Kroacisë:  
Njësia organizative kompetente vendore e Fondit Kroat të Sigurimeve Shëndetësore

2. Nëse një person i siguruar nuk paraqet një dokument të tillë, Institucioni Kompetent i Palës së parë Kontraktuese mund ta kërkojë dokumentin drejtpërdrejt nga Institucioni Kompetent i Palës së dytë Kontraktuese nga paragrafi 1 i këtij Neni.

## **Neni 6**

### **Autorizimi i përfitimeve në natyrë**

1. Me qëllim zbatimin e Nenit 13 të Marrëveshjes, personi i siguruar është i detyruar t'i paraqesë institucionit të vendbanimit një dokument të lëshuar nga institucioni kompetent që tregon të drejtën e tij/saj për përfitime në natyrë. Nëse personi i siguruar nuk disponon një dokument të tillë, Institucioni i vendbanimit mund të kërkojë nga institucioni kompetent lëshimin e dokumentit në mënyrë retrospektive.

2. Fushëveprimi i përfitimeve në natyrë të përmendura në Nenin 13 të Marrëveshjes përcaktohet nga legjislacioni i institucionit i vendqëndrimit.

3. Institucioni i vendqëndrimit është i detyruar t'i ofrojë përfitime në natyrë, sipas kushteve të parashikuara në Nenin 13 të Marrëveshjes, personit të siguruar sipas legjislacionit të Palës tjetër Kontraktuese, me të njëjtat kushte dhe në të njëjtat kushte si ato që zbatohen për personat e siguruar sipas legjislacionit të institucionit të vendit të qëndrimit.

4. Institucioni i vendqëndrimit, pasi njoftohet për ofrimin e trajtimit spitalor, me qëllim zbatimin e Nenit 13 të Marrëveshjes, është i detyruar të informojë menjëherë Institucionin kompetent për datën e pranimit në spital, kohëzgjatjen e parashikuar të trajtimit dhe/ose datës së pritshme të lëshimit.

5. Në rast të paaftësisë së përkohshme për punë të një personi të siguruar gjatë qëndrimit të tij në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, Institucioni i vendqëndrimit është i detyruar të njoftojë menjëherë Institucionin Kompetent.

6. Institucioni i vendqëndrimit do të kërkojë miratimin paraprak nga institucioni kompetent për ofrimin e protezave dhe përfitimeve të tjera thelbësore në natyrë të parashikuara në Nenin 13 të Marrëveshjes, përveç rasteve kur dhënia e përfitimeve në natyrë nuk mund të shtyhet, pa rrezikuar jetën ose shëndetin të personit të interesuar. Protezat dhe përfitimet e tjera thelbësore në natyrë sipas Nenit 13 të

Marrëveshjes do të përfshihen në Aneksin që është pjesë përbërëse e Marrëveshjes Administrative.

**Neni 7**  
**Rimbursimi i shpenzimeve**

Nëse një person i siguruar ka përballuar shpenzimet e përfitimeve në natyrë të parashikuara sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 13 të Marrëveshjes, institucioni i vendqëndrimit është i detyruar të japë informacion mbi tarifat e rimbursimit të zbatueshme për personin e tij të siguruar, me kërkesë të institucionin kompetent.

**Neni 8**  
**Përfitimet në para**

Përfitimet në para i paguhen drejtpërdrejt të siguarit nga Institucioni Kompetent.

**Kreu II**  
**AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE**

**Neni 9**  
**Autorizimi i përfitimeve në natyrë**

Për rastet e përfitimeve në natyrë të përmendura në Nenin 17 të Marrëveshjes, Nenet 6 dhe 7 të Marrëveshjes Administrative do të zbatohen sipas metodës mutatis mutandis.

**Neni 10**  
**Përfitimet në para**

Përfitimet në para të përmendura në Nenin 19 të Marrëveshjes i paguhen drejtpërdrejt personit të siguruar nga Institucioni Kompetent.

**Kreu III**  
**PËRFITIMET E PLEQËRISË, TË INVALIDITETIT DHE**  
**ANËTAREVE TË FAMILJES**

**Neni 11**  
**Bashkimi i Periudhave të Sigurimit**

Nëse sipas Nenit 20 të Marrëveshjes, për të ushtruar të drejtën e përfitimit, periudha e kërkuar e sigurimit është plotësuar në Palën tjetër Kontraktuese, atëherë Institucionit Kompetent të asaj Pale Kontraktuese do t'i kërkohej të dorëzojë formularët e ndërlidhjes me periudhat e sigurimit të deklaruara të plotësuara.

**Neni 12**  
**Paraqitja e një kërkesë pretendimi**

Institucioni Kompetent i Palës së parë Kontraktuese ku është paraqitur kërkesa do të kërkojë nga Kërkuesi të bashkëngjisë dhe të vendos në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm për Institucionin Kompetent të Palës tjetër Kontraktuese për të përpunuar

kërkesën, veçanërisht të dhënat për periudhat e sigurimit, llojin dhe vendet e punësimit, d.m.th., kryerjen e aktiviteteve, si dhe informacione për punëdhënësin.

### **Neni 13**

#### **Përpunimi i një kërkesë pretendimi me shkrim**

1. Institucionet kompetente janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën për çdo pretendim për përfitime dhe për të gjitha faktet me rëndësi për ushtrimin e të drejtave dhe përcaktimin e masës së përfitimit, përmes së cilës konfirmimi i të dhënave në formularin ndërlidhjes dygjuhëshe zëvendëson dorëzimin e dokumentacionit origjinal.
2. Institucionet kompetente i ofrojnë njëra-tjetrës edhe një pasqyrë të punësimit, d.m.th. aktivitetet e kryera në një Palë tjetër Kontraktuese, si dhe, eventualisht, në një Shtet të Tretë, me dokumentacionin përkatës në origjinal, ose një kopje të vërtetuar prej tyre.
3. Institucioni kompetent të cilit i është dorëzuar kërkesa për përfitim, konfirmon formularin ndërlidhës dygjuhësh, tek Institucioni Kompetent i palës tjetër Kontraktuese, periudhën e sigurimit, p.sh periudhën e pensionit që është marrë parasysh sipas rregullave ligjore të zbatuara.
4. Institucionet kompetente të të dy Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën, në momentin e krijimit të formularit ndërlidhjes dygjuhëshe, dhe të përfundimit të procedurës për përcaktimin e të drejtës së përfitimit.

### **Neni 14**

#### **Pagesa e Përfitimeve**

1. Institucionet kompetente do të paguajnë direkt përfitimet për përfituesit që kanë të drejtën e përfitimit.
2. Kur Institucioni Kompetent i njëres Palë Kontraktuese paguan përfitime në një monedhë të huaj e ndryshme nga ajo e Palës Kontraktuese, përfitimet përkatëse do të llogariten sipas kursit të këmbimit në ditën kur kryhet pagesa.
3. Tarifat bankare për transfertën e përfitimeve do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi të secilës Palë Kontraktuese.

### **Kreu IV**

#### **PËRFITIMET E PAPUNËSISË**

### **Neni 15**

#### **Bashkimi i periudhave të sigurimit**

1. Për të ushtruar të drejtat nga Neni 23 i Marrëveshjes, Institucionet Kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese, në formularin e krijuar dygjuhësh të ndërlidhjes, do të konfirmojnë periudhat e sigurimit të plotësuara të kërkuesit sipas rregullave ligjore që ata zbatojnë, si dhe periudhat gjatë të cilave janë paguar përfitimet e papunësisë.

2. Formulari i ndërlidhjes nga paragrafi 1 i këtij Neni lëshohet nga:

- për sa i përket Shqipërisë:  
Instituti i Sigurimeve Shoqërore

- për sa i përket Kroacisë:  
Shërbimet Kroate të Punësimit.

## **Kreu V** **DISPOZITAT FINANCIARE**

### **Neni 16** **Rimbursimi i shpenzimeve ndërmjet institucioneve**

1. Institucioni Kompetent rimbursion shpenzimet aktuale të përfitimeve në natyrë që u jepen personave të tyre të siguruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, institucionit në vendin e qëndrimit çdo 12 muaj, përveç rasteve kur organizohet ndryshe nga organet ndërlidhëse.
2. Institucioni kompetent është i detyruar të rimbursojë shpenzimet e padiskutueshme të përfitimeve të ofruara në natyrë për institucionin në vendqëndrim brenda 6 muajve nga marrja e kërkesës.
3. Procedura e detajuar e rimbursimit të shpenzimeve ndërmjet institucioneve do të përcaktohet nga organet ndërlidhëse të të dyja Palëve Kontraktuese.

## **PJESA IV** **DISPOZITA TË NDRYSHME**

### **Neni 17** **Ndihma Administrative**

1. Kur kërkohet ndihma administrative sipas nenit 25 të Marrëveshjes, shpenzimet operative të Institucionit Kompetent asistues do të sigurohen pa pagesë. Rimbursimi mund të kërkohet për shpenzime të tjera, me përjashtim të rasteve kur vendoset bashkërisht nga Autoritetet Kompetente ose Institucionet Kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese.
2. Institucioni Kompetent i njëjës Palë Kontraktuese do t'i sigurojë, sipas kërkesës, pa pagesë Institucionit Kompetent të Palës tjetër Kontraktuese çdo informacion dhe dokumentacion mjekësor që disponon lidhur me paaftësinë e një pretenduesi ose përfituesi.
3. Nëse Institucioni Kompetent i njëjës Palë Kontraktuese kërkon që një pretendues ose një përfitues që banon ose qëndron në territorin e Palës tjetër Kontraktuese t'i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor, institucioni kompetent i palës tjetër kontraktuese, me kërkesë të institucionit kompetent të Palës së parë Kontraktuese, do të kryej këtë ekzaminim në përputhje me rregullat e saj dhe me shpenzimet e Institucionit Kompetent që kërkon ekzaminimin.

4. Pas marrjes së një deklaratë të detajuar të shpenzimeve të kryera, Institucioni Kompetent i Palës së parë Kontraktuese, pa vonesë, do t'i rimbursojë institucionit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese shumat që i detyrohen si rezultat i zbatimit të paragrafit 3 të këtij Neni.
5. Institucioni Kompetent i secilës Palë Kontraktuese do të informojë Institucionin Kompetent të Palës tjetër Kontraktuese për ngjarjet që prekin të drejtat e përfituesve në fjalë, në masën e rregulluar nga legjislacioni i tij përkatës, duke përfshirë vdekjen, ndryshimin e adresës, ndryshimin e gjendjes civile dhe statusi i sigurimit. Procedurat e detajuara do të përcaktohen ndërmjet Organeve Ndërlidhëse.

### **Neni 18** **Shkëmbimi i Statistikave**

Organet ndërlidhëse të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë statistika në baza vjetore në lidhje me numrin e certifikatave që çdo Institucion Kompetent ka lëshuar sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Administrative dhe pagesat që secili ka bërë sipas Marrëveshjes. Këto statistika do të përfshijnë të dhëna për numrin e përfituesve dhe shumën totale të përfitimeve të paguara, sipas llojit të përfitimit. Këto statistika do të jepen në një formë që do të vendoset bashkërisht nga organet ndërlidhëse.

### **Neni 19** **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje Administrative do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe do të ketë po të njëjtën kohëzgjatje.

### **Neni 20** **Parimet Shtesë**

Kjo Marrëveshje Administrative do të zbatohet vetëm në kuadër të Marrëveshjes dhe legjislacionit përkatës të dy Palëve Kontraktuese.

Nënshkruar në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, kroate dhe angleze, të gjitha tekstet dhe shprehjet janë me fuqi të barabartë. Në rast të dallimeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Për Autoritetet Kompetente të  
Republikës së Shqipërisë

Datë: 2 Tetor 2023  
Vendi: Zagreb

Për Autoritetet Kompetente të  
Republikës së Kroacisë

Datë: 2 Tetor 2023  
Vendi: Zagreb